



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet

Rugovë, 22 qershor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Financa dhe Buxhet



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Financa dhe Buxhet organizoi takim e radhës të këtij Kolegjiut me 22 qershor 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Rugova Camp” në Rugovë të Pejës.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Rishikimi 6 mujor i buxheteve komunale,
- Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB-i komunal),
- Qarkorja buxhetore
- Pagat e stafit politik në komuna,

Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Financa dhe Buxhet nga Komunitat e Kosovës, po ashtu në takim ishin prezent edhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesja e Kolegjiut për Financa dhe Buxhet, znj. Afërdita Grapci.

PËRMBLEDHJE

• Rishikimi buxhetor

Në bazë të disa informatave jozyrtare Ministria e Financave nuk ka plane të qarta rreth procesit të rishikimit buxhetor për këtë vit. Me këtë rast pjesëmarrësit shprehën nevojën urgjente të shumicës së Komunave të cilat kanë identifikuar nevojën për rishikim dhe disa prej tyre vetëm kanë filluar një proces të tillë të brendshëm. Në bazë të indikacioneve preliminare, ky rishikim është i domosdoshëm sepse përndryshe ri-alokimi i mjeteve deri në 15% apo 25% sipas procedurave të parapara ligjore nuk do të mjaftonte për të mbuluar të gjitha nevojat. Rishikimi do të ndihmonte Komunitat në përbushjen e obligimeve të ndërmarra, përmirësimin e efektshmërisë si dhe realizim më të mirë buxhetor deri në fund të vitit. Prandaj Kolegjiut vendosi që t'i përcillet një kërkesë Ministrisë së Financave për të filluar procesin e rishikimit buxhetor sa më shpejtë që është e mundur, dhe komunave t'i lihet një afat prej minimum 3 javëve në mënyrë që të kenë kohë të mjaftueshme për konsultim kualitativ brenda komunave dhe miratim nga Kuvendet Komunale. Për më tepër, Kolegjiut fton të gjitha komunitat që të fillojnë procesin e ri-shikimit në mënyrë që të jenë të gatshme me kohë për një proces të tillë.

• KAB-et komunale

Gjatë diskutimit të kësaj pike u sqarua se komunitat janë në proces të përpilimit të KAB-eve komunale sipas kërkesës së MF-së, mirëpo për shkak të procedurave të brendshme komunale (aprovim i detyrueshëm nga Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe miratim i dëshirueshëm nga Kuvendi Komunal), të bëhet një kërkesë MF-së që afati për dorëzim të KAB-eve komunale në nivel qendror të jetë 15 korrik të çdo viti, për shkakun se në bazë të praktikave të deritanishme ka ekzistuar një afat i shkurtër kohor për t'i përbushur të gjitha procedurat e nevojshme. Po ashtu u kërkua nga drejtori për financa dhe buxhet nga Komunitat e Mitrovicës të përcjellë Kornizën Afatmesme Buxhetore zyrtarëve të AKK-së në mënyrë që të përcillet edhe komunave të tjera si shembull i mirë i organizimit dhe shkëmbimit të informatave.

- **Qarkorja buxhetore**

Përfaqësuesit për financa dhe buxhet informuan se komunat kanë marrë qarkoren buxhetore për buxhetin e vitit 2012 dhe janë në proces të planifikimit. Me këtë rast për shkakun e përmbushjes së obligimeve në planifikim u kërkua që qarkoret buxhetore t'i përcillen Komunave në fillim të prillit të çdo viti, sepse përndryshe Komunat nuk do të kenë afat të mjaftueshëm për të bërë një planifikim të mirëfilltë.

Në një analizë nga drejtorët komunal të Qarkores për buxhetin e vitit 2012, është vërejtur se granti specifik për arsim është zvogëluar për rreth 3 mil Euro në nivel të Kosovës. Me këtë rast u njoftua se kjo do të sjell pasoja shumë serioze në menaxhimin e institucioneve shkollore në kompetencë komunale. Sa për ilustrim, Komuna e Pejës p.sh. pas pagesës së pagave për personelin e arsimit do të ketë në dispozicion vetëm rreth 200,000 Euro për mallra dhe shërbime për 38 institucione shkollore që ka në menaxhim. Kjo gjendje është e ngjashme edhe në shumë Komuna tjera. Duke marrë parasysh inflacionin (si p.sh. rritja e çmimeve të lëndëve djegëse për ngrohje) këto mjete do të jenë të pamjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat e shkollave dhe pasojën kryesore të kësaj gjendjeje fatkeqësisht do ta bartin nxënësit.

- **Rritja e pagave për stafin politik komunal**

Po ashtu në takim u diskutua çështja e pagave për stafin politik komunal ku u ritheksua se Kolegjiumi dhe përfaqësuesit politik mirëpresin rritjen e pagave për shërbyesit civil dhe personelin arsimor dhe shëndetësor, mirëpo kjo rritje ka krijuar çekuilibrim në mes të pagave të stafit politik dhe atij civil komunal. Tani pagat e personelit arsimor dhe shëndetësor si dhe të disa kategorive të punëtorëve të administratës komunale tejkalojnë pagat e eprorëve të tyre. Ky çekuilibrim ka shkaktuar mungesë të vullnetit të stafit politik që mund të reflektohet edhe në punën e tyre, dhe për të evituar problemet e mundshme në këtë drejtim Kolegjiumi për financa dhe buxhet kërkon edhe korrigjim në sistemin e pagave. Duke pasur parasysh se eprorët dhe stafi politik kanë përgjegjësi më të madhe, Kolegjiumi konsideron se edhe pagat e tyre duhet të nivelizohen në përputhje me rrethanat e reja.

KONKLuzionET

- AKK të dërgojë një kërkesë në MF për të kërkuar:
 - i) ri-shkimi buxhetor të fillojë sa më shpejtë që është e mundur
 - ii) afati për dorëzimin e KAB-eve nga komunat të jetë 15 korrik të çdo viti
 - iii) MF të përcjellë qarkorën buxhetore tek komunat në fillim të prillit të çdo viti
 - iv) mos të zvogëlohet granti specifik për arsim
 - v) të rriten pagat e stafit politik komunal.
- Komunat në ndërkohë të fillojnë planifikimin buxhetor